



Universiteti i Elbasanit
"ALEKSANDËR XHUVANI"

Fakulteti i Shkencave të Edukimit

THIRRJE PËR PJESËMARRJE

Konferenca e 5-të Ndërkombëtare

"Edukimi, Integrimi global dhe Sporti"
Në kuadër të Kongresit të 20-të Evropian të FIEPS



1-2 MAJ 2026

Elbasan

Fakulteti i Shkencave të Edukimit në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" shpall thirrjen për pjesëmarrje dhe bashkëpunim në **Konferencën e 5-të Ndërkombëtare për Edukimin, Integrimin global dhe Sportin, në kuadër të Kongresit të 20-të Evropian të FIEPS**, e cila do të mbahet në 1-2 maj 2026 në Elbasan.

Konferenca synon të mbledhë akademikë, studiues, profesionistë vendas dhe të huaj, drejtues dhe mësues të sistemit të arsimit parauniversitar, specialistë psiko-socialë, të diplomuarit alumni, studentë ekselentë të programeve të studimit në mësuesi dhe ekspertë të tjerë të arsimit dhe të sportit, ku mund të parashtrohen jo vetëm probleme, por të propozohen edhe zgjidhje shkencore.

Tematikat kryesore të kësaj konference do të jenë të fokusuara dhe do të trajtojnë studime/referime/raste studimore në fushat e mëposhtme:

1. Edukimi, mësimdhënia dhe të nxënit në kontekstin bashkëkohor

- Teoritë dhe praktikat moderne të mësimdhënies
- Zhvillimi i kompetencave në shek. XXI
- Përdorimi i teknologjisë dhe inovacionit në edukim
- Edukimi fizik dhe roli i tij në formimin e nxënësve

2. Aktiviteti fizik, sporti, shëndeti dhe mirëqenia

- Aktiviteti fizik dhe ndikimi në shëndetin publik
- Edukimi për shëndetin dhe ushqyerjen
- Sporti, fitness dhe rekreacioni
- Parandalimi i sëmundjeve dhe promovimi i stilit aktiv të jetesës

3. Zhvillimi i fëmijëve dhe të rinjve nëpërmjet edukimit dhe lëvizjes

- Zhvillimi motorik, kognitiv dhe socio-emocional
- Roli i lojës, sportit dhe aktivitetit fizik në zhvillim
- Edukimi parashkollor dhe shkollor

4. Psikologjia, këshillimi dhe shërbimet psikosociale në edukim dhe sport

- Psikologjia e edukimit dhe e sportit
- Shërbimet psikosociale në shkolla dhe institucione
- Mirëqenia emocionale dhe menaxhimi i stresit
- Përballja me sfidat sociale dhe globale tek të rinjtë

5. Përfshirja sociale, diversiteti dhe edukimi gjithëpërfshirës

- Edukimi gjithëpërfshirës dhe barazia në arsim
- Aktiviteti fizik i adaptuar dhe përfshirja
- Edukimi për qytetarinë dhe zhvillimin social
- Sporti si mjet për integrim dhe kohezion social

6. Menaxhimi, politika dhe zhvillimi institucional në edukim dhe sport

- Menaxhimi i institucioneve arsimore dhe sportive
- Politikat arsimore dhe sportive
- Zhvillimi i programeve dhe kurrikulave
- Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar

Informacione për pjesëmarrjen në konferencë:

Dërgimi i abstraktit	16 Prill 2026
Njoftimi për pranimin e abstraktit	16 Prill 2026
Dërgimi i artikullit të plotë	25 Prill 2026
Data e konferencës	01-02 Maj 2026
Vendi	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
Gjuha zyrtare e konferencës	Anglisht, shqip

Koha e prezantimit	10-15 minuta
Adresa zyrtare	https://fieps2026.assa.al
Pagesa e konferencës	Referues i parë - 2000ALL Bashkëautor - 1000 ALL Anëtarët e UE-së - pa pagesë

Formati i prezantimit të abstraktit dhe përmbledhjes së punimit:

<https://fieps2026.assa.al/scientific-guidelines>

Hapat për prezantimin e punimit:

- Dërgoni abstraktin në adresëne-mail: Format i prezantimit të abstraktit dhe përmbledhjes së punimit <https://fieps2026.assa.al/scientific-guidelines> duke përcaktuar sesionin e përzgjedhur.
- Konfirmimi për pranimin e abstraktit do të dërgohet në rrugë elektronike në adresën personale të aplikantit